

Recension

STUDIME TË RËNDËSISHME PËR FOLKLORIN DHE ETNOLOGJINË

Izaim Murtezani, *Interpretime folklorike dhe etnologjike*, botoi: Izaim Murtezani, shtypshkronja “BoroGrafika”, Shkup, 2019, 268 faqe.



Librave studimorë të autorit dhe studiuesit të njohur të folklorit, Izaim Murtezani, i është shtuar edhe një botim i ri nga fusha e folklorit dhe etnologjisë. Libri, me titull *Interpretime folklorike dhe etnologjike*, trajton çështje të rëndësishme nga këto dy fusha, duke përfaqësuar një vlerë të shtuar për albanologjinë. Gjithashtu, është një burim i

çmuar për studiuesit që merren me etnologjinë dhe folklorin.

Ky botim përfshin një numër të madh studimesh, në të cilat autori analizon tema të rëndësishme si për folklorin, ashtu edhe për etnologjinë. Këto studime trajtohen nga perspektiva teorike dhe empirike, duke dëshmuar përkushtimin e autorit si në fushën akademike, ashtu edhe në atë hulumtuese. Në mënyrë të veçantë, autori ofron shembuj dhe argumente të mbledhura nga puna e tij kërkimore në terren, duke ilustruar mënyrat e jetesës dhe transformimet e tyre përmes periudhave të ndryshme historike. Një aspekt qendror i studimeve është trajtimi i trashëgimisë shpirtërore dhe asaj materiale, e cila, ndonëse është ruajtur ndër gjenerata, ka pësuar edhe ndryshime të ndjeshme për shkak

të proceseve globale. Studimet e përfshira në këtë libër janë rezultat i një pune shumëvjeçare të autorit dhe janë botuar në vëllime si rezultat i pjesëmarrjeve të ndryshme shkencore si në Maqedoninë e Veriut, ashtu edhe më gjerë. Përmbledhja e këtyre punimeve në një libër unik u lehtëson studiuesve qasjen në to, duke i bërë më të arritshme dhe më të sistematizuara.

Libri përpos hyrjes është i klasifikuar në katër njësi (ashtu siç i quan ai) apo grupe ku i ka klasifikuar studimet në bazë të tematikave të përbashkëta apo të afërta me njëra-tjetrën. Dr. Izaim Murtezani e ka organizuar librin në katër njësi tematike, duke siguruar një strukturë të qartë për çdo punim, që përfshin hyrjen, zhvillimin, përfundimet dhe literaturën e përdorur. Megjithëse punimet janë të ndara sipas tematikave të veçanta, ato krijojnë një tërësi koherente brenda librit, duke ofruar një burim të pasur për studiuesit dhe lexuesit e interesuar në këto fusha. Ky libër dëshmon punën serioze dhe kontributin e çmuar të Dr. Murtezanit në fushën e folklorit dhe etnologjisë, duke

sjellë një dimension të ri në studimet albanologjike.

Njësinë e parë e ka titulluar *Aspekte mitike në narracionet popullore*, në të cilën i ka përfshirë katër punime. Në punimin e parë *Pema e botës (Sipas disa shembujve të përrallave tona fantastike)* përmes përrallave tregohet për besimin magjik për drurin, ku sipas besimit në majën e tij ndodhej zogu gjegjësisht shqiponja duke iu atribuar hyjnive qiellore, ndërsa në rrënjë gjarpri duke iu atribuar hyjnive nëntokësore. Ndërsa ky përfytyrim për drurin në mitologjinë e popujve të lashtë ndërlidhet me pemën kozmike, e cila paraqet tri nivelet e gjithësisë. Degët botën qiellore, trangu botën tokësore, ndërsa rrënja e përfaqëson botën nëntokësore. Motiv ky i bartur edhe në përrallat tona por në një mënyrë shumë më të modifikuar dhe të reduktuar. Studimi i dytë me titull *Gjurmë të një hierogamia kozmike në strukturën përmbajtjesore të disa përrallave tona*, autori ka trajtuar një çështje specifike siç është hierogamia kozmike apo martesat e shenjta që është një dukuri e rëndësishme e

mitologjisë botërore, por edhe shqiptare. Ky fenomen ka të bëjë me krijimin e botës, i cili nënkupton martesën në mes të qiellit si mashkull dhe tokës si femër prej nga është krijuar bota dhe të gjitha pjesët përcjellëse të saj. Gjurmë të këtij fenomeni hasim edhe te disa përralla tona, i cili është reflektuar përmes diellit dhe hënës. Në punimin e tretë shkencor me titull *Aspekte narratologjike të përrallës: Kordha, ylli dhe deti*, përrallë e mbledhur nga Thimi Mitko autori ka nxjerrë në pah elemente që lidhen me ritin e rishtarisë, përmes saj janë shpalosur aspektet narratologjike të kësaj përralle. Ndërsa punimi i fundit në këtë njësi është *Kah interpretimi i legjendave popullore me motivin 'Lindja e Skënderbeut'*, në të cilin autori e trajton një zhanër tjetër që është ai i legjendave popullore, të cilat i dedikohen heroit kombëtar Skënderbeut. Për të trajtuar këtë figurë ai ka sjellë disa legjenda, të cilat janë të lidhura kryesisht me lindjen e mbinatyrshme të Skënderbeut, mesazh ky i cili përcillet përmes përmbajtjes së ëndrrave.

Në njësinë e dytë me titull *Aspekte mitike dhe historike në këngët popullore* janë të përfshira gjithsej pesë punime, të cilat kanë tematikë të njëjtë. Punimi i parë është *Imazhi për Tjetrin (Sipas disa shembujve të eposit heroik shqiptar dhe atij të sllavëve të Jugut)*. Në këtë studim Murtezani duke bërë krahasime në mes të dy eposeve heroike të këtyre dy popujve, shqiptarëve dhe sllavëve të Jugut, përmes analizës ai vë në pah perceptimin e Tjetrit në këto këngë ku për bazë e ka mitin. Studimi në vazhdim është *Gjurmë të ritit të rishtarisë në variantet e këngës kërçovare "Beno Bajraktari"*, autori përmes kësaj këngë është përpjekur të sjellë marrëdhënien e kësaj kënge me ritualin e rishtarisë. Është e ditur tanimë se, pjesa dërrmuese e krijimtarisë popullore i ka për bazë elementet e ritualeve të lashta pagane. Punimi në vazhdim është ai me titull *Mbijetoja të eposit të kreshnikëve në trevën e Dervenit të Shkupit*, në të cilin ka sjellë të dhëna për praninë e këtyre këngëve në këtë zonë. Këto këngë kanë qenë të pranishme edhe në Tetovë, Kërçovë e

Gostivar, por ato janë përshtatur me interpretimin dyzërësh që është karakteristikë për këto vende në Maqedoninë e Veriut. Gjithashtu autori vë në pah edhe dëshminë se këngët në zonën e Dervenit nuk janë shoqëruar me instrumente muzikore, për këtë arsye edhe këngët kreshnike janë interpretuar pa instrumente muzikore. *Shkupi ndërmjet dy luftërave botërore në rapsodinë popullore* është studimi i radhës, në të cilin autori përmes disa këngëve popullore, që përputhen edhe me të dhëna historike tregon aktivitet për kauzën kombëtare të zhvilluara në Shkup, si një qendër e rëndësishme e Mbretërisë Jugosllave. Ai përmes këtyre ndodhive që paraqesin këto këngë na e pasqyron një realitet të asaj kohe ku për qëllim kishte interesin kombëtar shqiptar. Punimi i fundit i kësaj njësie është *Institucioni i mikpritjes dibrane*, mikpritja si një virtyt i traditës shqiptare dhe institucion në të drejtën zakonore na sjell fakte konkrete për mikpritjen e Dibrës si një zonë ndërlidhëse me zonat e tjera. Ajo, ishte e njohur për mikpritjen si një aset i trashëguar, por që gjithsesi

kalimin e kohës edhe kishte pësuar ndryshme racionale duke u përshtatur me kohën. Në klasifikimin e njësisë së tretë autori ka sjellë gjithsej katër studime, ku përmes tyre ka trajtuar disa aspekte të ngjashme tematike që kanë të bëjnë me kalendarin e festave pagane. Punimi i parë është *Festat pagane kalendarike te shqiptarët e Maqedonisë së Veriut në cilësinë e riteve të kalimit*. Të gjitha festat pagane bazën e kanë në ditë të caktuara kur ka ndryshuar koha, stinët. Të gjitha këto ndryshime kohore janë shoqëruar me rite e praktika magjike, në të cilat ata kanë besuar se kanë ndikim indirekt apo të drejtpërdrejtë në këto periudha të reja kohore. Punimi i dytë *Simbolika e Verores në kremten pagane të Ditës së Verës te Shqiptarët e Maqedonisë së Veriut*, përmes një analize të mirëfilltë, autori këtu sjell të dhëna për ritualet dhe veprimet magjike që janë praktikuar gjatë kësaj feste pagane. Është ndalur në mënyrë të veçantë duke sjellë të dhënë për kuptimin e simbolikën e ngjyrave të verores që janë e bardha dhe e kuqja, pra penjtë

me të cilët është punuar verorja si një objekt magjik, i cili sjell shëndet e të mira për personin që e bart në dorë. Punimi në vazhdim është ai me titull *Arapit të Zi ne Karnavalet ilire të malësisë së Sharrit të Tetovës*, në të cilin e ka analizuar këtë figurë kyçe e protagonistë të karnavalit si një praktikë magjike të këtij rituali i cili vazhdon të praktikohet dhe në ditët e sotme. Punimi i fundit i kësaj njësie tematike është *Parodia e një dasme të shenjtë (Sipas shembullit të dasmës së improvizuar të Shëngjergjit në f. Reçan të Gostivarit)* përmes këtij punimi autori përpiket të na sjellë kuptimin mitik të një rituali shumë të lashtë përmes të cilit bëhet stimulimi i një dasme komike. Në rolin e nuses në këtë dasmë komike paraqitet një djalë i ri, por i cili në fund e tregon identitetin e tij gjinor. Sipas autorit, ky ritual ka për qëllim të sjellë gjurmë të mitit për androgjininë thënë ndryshe mitin përmes të cilit besohet se fillimisht bota është krijuar nga një qenie hyjnore, e cila i kishte dy gjinitë - mashkullore dhe femërore.

Në njësinë e fundit tematike janë përfshirë dy punime studimore. Në studimin e parë me titull *Kah folklorizmi i ideologjizuar*, autori ka trajtuar krijimet të cilat janë krijuar në Shqipëri në kohën e sistemit socialist që udhëhiqej nga Enver Hoxha. Gjatë kësaj kohe ishin krijuar këngë përmes të cilave janë pasqyruar zhvillime të ngjarjeve të asaj periudhe. Sipas autorit këto këngë 'janë të diskursit ideologjik dhe vetëm për një përdorim, ato nuk u bartën në gjeneratat e ardhshme', sido që të jetë këto këngë kanë mbetur pjesë e kujtesës kolektive. Punimi i fundit është ai me titull *Folklori dhe interneti - Drejt paradigmave të reja eksploruese*, në këtë punim autori paraqet mundësitë e reja, të cilat i ofron zhvillimi i teknologjisë, ku interneti mund të shfrytëzohet si terren të cilin studiuesit mund ta shfrytëzojnë si në aspektin teorik, ashtu edhe atë empirik. Pra, janë mundësitë shumë më të lehta për të realizuar hulumtime, për të vënë kontakte me subjekte të ndryshme për hulumtime që kanë të bëjnë me studime të ndryshme.

Ky libër përfaqëson një vlerë të shtuar për studimet në fushat e folklorit, të etnologjisë dhe të antropologjisë, duke kontribuar gjithashtu si një thesar i çmuar për ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore shqiptare. Studimet e përfshira në këtë libër trajtojnë tema shumë specifike dhe unike të kulturës shpirtërore shqiptare, duke ofruar një perspektivë të thelluar mbi traditat, zakonet dhe ritualet që përbëjnë identitetin kulturor të popullit shqiptar.

Këto studime janë një burim i vlefshëm jo vetëm për studiuesit

që angazhohen në kërkime shkencore, por edhe për studentët që aspirojnë të kuptojnë dhe të analizojnë më tej këto disiplina. Libri ofron një bazë të rëndësishme teorike dhe empirike, duke shërbyer si një udhërrëfyes për hulumtime të mëtejshme në këto fusha relevante. Në këtë mënyrë, *Interpretime folklorike dhe etnologjike* jo vetëm që pasuron literaturën shkencore, por edhe krijon një urë lidhëse midis traditave të kaluara dhe nevojave të sotme të kërkimit dhe ruajtjes së trashëgimisë

Vlorë Fetaj-Berisha